



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

Raport i punës
së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës
për Shërbimin Civil të Kosovës për
vitin 2018

Prishtinë
Mars 2019

**FJALA E KRYETARIT TË KËSHILLIT TË PAVARUR MBIKËQYRËS PËR
SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS, ESHREF SHABANI**

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë, që të prezentoj Raportin vjetor të punës së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2018. Ky raport, pasqyron kryerjen e funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit, si institucion i pavarur kushtetues për mbikëqyrjen e respektimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil.

Këshilli me profesionalizëm është angazhuar që të mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil nga institucionet e administratës publike të nivelit qendror dhe lokal dhe është dëshmuar si institucion që ka punuar me përkushtim, në mënyrë të paanshme, në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin, duke kontribuar nga fushëveprimtaria e tij, që shërbimi civil të jetë profesional dhe i paanshëm, si dhe të pasqyroj diversitetin e popullit të Kosovës, duke përfshirë parimin e barazisë gjinore.

Në raportin vjetor të punës, përfshihen të dhëna për punët e kryera në kuadër të funksionit të shqyrtimit dhe vendosjes për ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, funksionit të mbikëqyrjes së procedurës së përzgjedhjes dhe vendosjes në emërimet e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe nivelit drejtues si dhe funksionit të monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, përfaqësimin e Këshillit në procedura gjyqësore, bashkëpunimin e Këshillit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare si dhe pjesëmarrjen e Këshillit në konferenca dhe takime të rëndësishme lidhur me proceset reformuese në administratën publike.

Viti 2018 ka qenë sfidues për Këshillin pasi që kemi pasur numër të madh të ankesave. Në vlerësojmë, që numri i madh i ankesave, nuk është pasojë e shkeljeve me të shumta në shërbimin civil, se në vitet paraprake, por është një vetëdijesim me i madh i nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil që të shfrytëzojnë të drejtën e ankimit në rastet kur vlerësojnë që ju kanë cenuar të drejtat nga marrëdhënia e punës si dhe një besim i shtuar në vendimmarrjen e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

Më këtë rast, falënderoj anëtarët e Këshillit për përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar, duke bërë që Këshilli të vendos për të gjitha ankesat, brenda afateve të përcaktuara me ligj. Po ashtu, falënderoj drejtorin ekzekutiv, bashkëpunëtorët profesional dhe nëpunësit tjerë të sekretarisë, që kanë ofruar mbështetjen e tyre profesionale dhe administrative, fal të cilës kemi arritur që t'i realizojmë me sukses funksionet e Këshillit.

Gjatë vitit 2018, Këshilli për herë të parë ka nxjerr publikimin e Buletinit të vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Ky Buletin përmban një përmbledhje të vendimeve me të rëndësishme nga funksioni i ankesave, të cilat janë të natyrave të ndryshme të mënyrës së vendimmarrjes, janë të gjitha natyrave të çështjeve juridike si dhe të ankuesve të komuniteteve dhe gjinive të ndryshme.

Këshilli me vota unanime më ka zgjedhur për të udhëhequr këtë institucion të rëndësishëm. Nga data 1 Korrik 2018 është bërë kalimi i udhëheqjes së Këshillit nga Kryetari, z. Shkëmb Manaj tek

unë dhe ky mbetet një shembull i transferit normal të përgjegjësive dhe vazhdimësisë së punës në Këshill. Më këtë rast, shpreh konsideratën time dhe të anëtarëve të Këshillit, për punën e madhe që ka kryer z. Manaj në udhëheqjen e Këshillit gjatë mandatit të tij.

Viti 2018 konsiderohet vit i avancimit të rolit të Këshillit në kuadër të institucioneve të pavarura kushtetuese. Në këtë vit, është aprovuar Ligji i ri për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civilë të Kosovës i cili është inicuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Me këtë ligj, Këshillit i jepet kompetenca e mbikëqyrjes së procedurave të përzgjedhjes në pozitat e nivelit të lartë drejtues në shërbimin civil si dhe përcaktohen të drejta dhe obligime shtesë në fushëveprimin e Këshillit.

Këshilli gjatë këtij viti raportues në kuptim të zbatimit të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civilë të Kosovës, brenda një afati optimal, ka nxjerr pesë akte nënligjore të përcaktuara me nenin 30 të këtij Ligji.

Po ashtu, gjatë këtij viti raportues Këshilli ka marrë pjesë në procesin e hartimit të pakos ligjore të administratës publike, respektivisht Ligjit për Zyrtarët Publikë, Ligjit për Paga në sektorin publikë si dhe Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.

Shpresoj që ky Raport do t'ju hyj në punë institucioneve të administratës publike që hartojnë politikat e shërbimit civil, nëpunësve civilë, studiuesve dhe organizatave tjera qeveritare dhe joqeveritare kombëtare dhe ndërkombëtare, që në fushëveprimin e tyre e kanë administratën publike, respektivisht shërbimin civilë.

Rekomandimet e dhëna në këtë Raport, nëse adresohen, do të ndikojnë në reformimin e administratës publike dhe në avancimin e shërbimit civilë të Republikës së Kosovës.

Eshref Shabani
Kryetar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

TABELA E PËRMBAJTJES

	Fjala e kryetarit të Këshillit	2
1.	Përmbledhje ekzekutive	5
2.	Korniza ligjore	6
3.	Fushëveprimi i Këshillit	7
4.	Organizimi i Këshillit	8
5.	Aktivitetet e Këshillit për periudhën raportuese	9
5.1.	Funksioni i shqyrtimit të ankesave	9
5.1.1	Ankesat e pranuar sipas objektit	9
5.1.2	Ankesat e pranuar sipas strukturës gjinore të ankuesve	11
5.1.3	Ankesat e pranuar sipas strukturës etnike të ankuesve	12
5.1.4	Ankesat e pranuar sipas institucioneve ndaj vendimeve të të cilave është paraqitur ankesë	13
6.	Ankesat e pranuar kundër vendimeve të institucioneve	15
6.1	Ankesat kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore	15
6.2	Ankesat kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale	24
7.	Ndarja e ankesave sipas formës së vendosjes	25
7.1.	Të aprovuara	25
7.2.	Pjesërisht të aprovuara	25
7.3.	Të refuzuara	25
7.4.	Të hedhura poshtë	25
7.5.	Të shpallura jo-kompetent	25
7.6.	Detyrimi i organit administrativ për të nxjerr aktin administrativ	25
7.7.	Kthimi në rishqyrtim	26
7.8.	Përfundim i procedimit administrativ	26
8.	Formate vendosjes kundër vendimeve të institucioneve	27
8.1.	Format e vendosjes kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore	27
8.2.	Format e vendosjes kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale	31
9.	Zbatimi i vendimeve të Këshillit nga organet e punësimit	33
10.	Funksioni i Monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjisllacionit për shërbimin civil	37
11.	Funksioni i mbikëqyrjes së përzgjedhjes të nëpunësve civil të nivelit drejtues dhe nivelit të lartë Drejtues.	45
12.	Rekomandimet dhe sfidat e Këshillit	65
13.	Vendimet e Gjykatave	67
14.	Bashkëpunimi i Këshillit me institucionet e tjera	68
15.	Krahasimi i punës së Këshillit për vitin 2018 me punën e Këshillit për vitin 2017	69
16.	Raporti për shpenzimin e buxhetit të Këshillit	72

1.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i punës për vitin 2018, përmban të dhëna dhe informata të detajuara për të gjitha aktivitetet dhe punët e kryera nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Në raport përfshihen të dhëna për punët e kryera në kuadër të funksionit të shqyrtimit dhe vendosjes për ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, funksionit të mbikëqyrjes së procedurës së përzgjedhjes dhe vendosjes për emërimet e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe nivelit drejtues si dhe funksionit të monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Po ashtu, në këtë Raport janë përfshirë edhe aktivitetet tjera të Këshillit, si përfaqësimi i Këshillit në procedura gjyqësore, bashkëpunimi i Këshillit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, si dhe pjesëmarrjen e Këshillit në konferenca dhe takime të rëndësishme lidhur me proceset reformuese në administratën publike .

Këshilli gjatë vitit 2018, ka arritur që të shqyrtojë dhe vendos në mënyrë meritore për 825 ankesa të nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, ndërsa 112 ankesa janë bartur për vendosje në vitin 2019.

Këshilli gjatë vitit 2018, ka mbikëqyrur 581 pozita. Nga 581 pozita Këshilli ka nxjerr vendim për katërqind e katër dhjetë e shtatë (447) pozita të rekrutimit lidhur me procesin e emërimeve të nëpunësve civil të nivelit drejtues dhe nivelit të lartë drejtues. Nga katërqind e katër dhjetë e shtatë (447) pozita që janë vendosur, Këshilli ka aprovuar si të rregullta dyqind e njëzet e pesë (225) pozita të rekrutimit, ndërsa për shkak të shkeljeve ligjore dhe procedurale, ka anuluar dyqind e njëzet e dy (222) pozita të rekrutimit të nëpunësve civil të nivelit drejtues dhe nivelit të lartë drejtues.

Në kuadër të funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, në pajtim me Planin e Monitorimit, Këshilli ka realizuar gjashtëdhjetë e tri (63) vizita monitoruese në institucionet e nivelit qendror dhe lokal.

Në raportet e monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për institucionet e nivelit qendror dhe lokal, Këshilli ka evidentuar dhe ka konstatuar treqind e pesëdhjetë e dy (352) shkelje të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, dhe për shkeljet e evidentuara ka dhënë treqind e tetëdhjetë e tri (383) rekomandime për zyrtarët përgjegjës të institucioneve të monitoruara (në këtë numër te të gjeturave dhe rekomandimeve janë përfshirë edhe te gjeturat dhe rekomandimet të katër raporteve të monitorimit te cilat janë përfunduar nga kolegjet por nuk janë shqyrtuar dhe vendosur në Këshill për shkak të mungesës se kuorumit të vendimmarrjes).

2. KORNIZA LIGJORE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kryen funksionet dhe përgjegjësitë në pajtim me:

- Kushtetutën e Republikës së Kosovës,
- Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;
- Ligjin Nr.03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
- Rregulloren Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- Rregulloren Nr.03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Mbikëqyrjes së Përzgjedhjes të nëpunësve Civil të Lartë Drejtues dhe Nivelit Drejtues;
- Rregulloren Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike Lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil; dhe
- Rregulloren Nr. 05/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me datën 25.08.2018 ka hyrë në fuqi Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli në afat optimal, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e Ligjit për Këshillin, ka nxjerr aktet e reja nënligjore, si në vijim:

- Rregulloren Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- Rregulloren Nr.03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Mbikëqyrjes së Përzgjedhjes të nëpunësve Civil të Lartë Drejtues dhe Nivelit Drejtues;
- Rregulloren Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike Lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil; dhe
- Rregulloren Nr. 05/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

3. FUSHËVEPRIMI I KËSHILLIT

Këshilli është organ i pavarur i cili mbikëqyr respektimin e të gjitha rregullave dhe parimeve që rregullojnë Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës dhe për punën e tij i raporton drejtpërdrejtë Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është paraparë me nenin 101 paragrafin 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe me Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me dispozitat e Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës janë përcaktuar funksionet e Këshillit si në vijim:

- shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil
- mbikëqyr procedurën e përzgjedhjes dhe vendos nëse emërimet e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, janë zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil;
- Monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civilë, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Me qëllim të ushtrimit të funksioneve, Këshilli mund të:

- vizitojë çdo vend ku janë të punësuar nëpunësit civilë;
- ketë qasje dhe të kontrollojë dosjet dhe çdo dokument lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil;
- intervistojë çdo nëpunës civil, i cili mund të ketë informata që kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për ushtrimin e funksioneve të Këshillit;
- kërkon dhe merr nga institucionet çdo informacion të nevojshëm për kryerjen e detyrave të tij
- organizon seanca profesionale; dhe
- nxjerr vendime, udhëzime qëndrime dhe rekomandime.


4. ORGANIZIMI I KËSHILLIT

Organizimi i brendshëm i Këshillit është i rregulluar me Ligjin Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe me Rregulloren Nr.05/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me dispozitat e këtij Ligji është përcaktuar edhe përbërja e Këshillit, ku përcaktohet që Këshilli përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve, që emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në bazë të procedurave të hapura dhe transparente, dhe po ashtu që përbërja e Këshillit pasqyron karakterin shumë etnik dhe gjinor të Republikës së Kosovës.

Sekretaria e Këshillit i ofron mbështetje administrative dhe profesionale-juridike Këshillit në ushtrimin e funksioneve kushtetuese dhe ligjore. Sekretaria udhëhiqet nga Sekretari i Përgjithshëm dhe ka të punësuar 21 nëpunës civilë. Në kuadër të Sekretarisë funksionon Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme dhe Divizioni për Mbështetje Profesionale

Organogrami i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës



5. AKTIVITETET E KËSHILLIT PËR PËRIUDHËN RAPORTUESE

Në vijim të raportit, paraqesim një pasqyrim të plotë të mënyrës së ushtrimit të funksioneve nga Këshilli, respektivisht për procesin e shqyrtimit të ankesave, procesin e mbikëqyrjes së emërimeve të nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe nivelit drejtues si dhe procesin e monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë periudhës raportuese 1 Janar -31 Dhjetor 2018.

5.1.FUNKSIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE

Këshilli gjatë vitit 2018 ka pranuar gjithsej 863 ankesa të cilat janë parashtruar nga nëpunësit civilë, si dhe nga kandidatët për pranim në shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

Këshilli, përveç 863 ankesave të pranuar, në shqyrtim ka pasur edhe 74 ankesa, të cilat janë bartur nga viti 2017 për vendosje në vitin 2018. Bazuar në këto të dhëna, rezulton që Këshilli gjatë vitit 2018 ka pasur në shqyrtim gjithsej 937 ankesa.

Nga 937 ankesa të pranuar për shqyrtim gjatë vitit 2018, Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore për 825 ankesa dhe 112 ankesa janë bartur për tu vendosur brenda afatit ligjor në vitin 2019. Ankesat e bartura për vitin 2019 janë ankesa të pranuar kryesisht gjatë muajit dhjetor 2018.

Këshilli nga data 19.12.2018 ka mbetur me vetëm tre anëtarë sepse sipas shkresës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, 4 anëtarëve si në vijim: Shkëmb Manaj, Hajzer Salihu, Lulzim Aliaj dhe Gjylinaze Novebërdali Gola, ju ka përfunduar mandati i rregullt 5 vjeçar.

Prej këtij momenti, Këshilli ka mbetur pa vendimmarrje në funksionin e mbikëqyrjes dhe monitorimit sepse nuk ka pasur kuorum për vendimmarrje, ndërsa ka pasur vetëm një koleg prej tre anëtarëve i cili ka nxjerr vendime vetëm në funksionin e ankesave deri me datën 21 janar 2019, kur nga Këshilli ka dhënë dorëheqje anëtarja nga përkatësia etnike serbe, Lela Petkoviç pasi që është emëruar gjyqtare në gjykatë të rregullt dhe nga kjo datë, Këshilli ka mbetur plotësisht jashtë funksionit.

Ky raport përmban të dhëna statistikore për ankesat e pranuar sipas:

1. objektit të ankesës:
2. strukturës gjinore të ankuesve:
3. strukturës etnike të ankuesve: dhe
4. institucioneve ndaj vendimeve të të cilave është paraqitur ankesë:

5.1.1.Ankesat e pranuar sipas objektit të ankesës


Në Këshill, janë pranuar ankesa, të cilat kanë pasur objekt të ndryshëm të ankimimit dhe të ndara sipas llojit të objektit. Ndarja e ankesave sipas objektit pasqyrohet në numra dhe në përqindje në tabelën në vijim :

Nr.	Objekti i ankesave	Numri i ankesave	Përqindja
1	Kontestim konkursi	366	42.41%
2	Kompensim material	163	18.89%
3	Ndërprerje e marrëdhënies së punës	84	9.73%
4	Kërkesa nga marrëdhënia e punës	76	8.80%
5	Masë disiplinore	62	7.18%
6	Transferime	28	3.24%
7	Shkelje e të drejtës në pagë	23	2.66%
8	Pezullim parandalues	19	2.20%
9	Kundër caktimit të ushtruesit të detyrës	12	1.39%
10	Moszbatim i vendimeve të komisionit të ankesave	10	1.15%
11	Vlerësim i punës	10	1.15%
12	Çështje të avancimit në karrierë	4	0.46%
13	Ulje në pozitë	3	0.34%
14	Mos vazhdim i kontratës së punës	3	0.34%
	Gjithsejtë:	863	100%

Tabela nr. 1 paraqet ankesat e pranuar sipas objektit të ankesës në vitin 2018



Diagrami nr.1 paraqet të dhënat e tabelës nr.1




Vazhdim i diagramit nr.1

5.1.2. Ankesat e ushtruara sipas strukturës gjinore të ankuesve

Nga 863 ankesa të pranuar në vitin 2018, ndarja sipas strukturës gjinore të ankuesve është si në vijim: ankues meshkuj kanë qenë 569 ose 65.93%, ndërsa ankuese femra kanë qenë 294 ose 34.06%.

Nr. Rendor	Ankesat e ushtruara sipas strukturës gjinore	Numri	Përqindja
1	Meshkuj	569	65.94%
2	Femra	294	34.06%

Tabela nr. 2 paraqet ankesat e pranuar sipas strukturës gjinore të ankuesve




Diagrami nr.2 paraqet të dhënat e tabelës nr.2

5.1.3 .Ankesat e pranuar sipas strukturës etnike të ankuesve

Nga 863 ankesa të pranuar në vitin 2018, prej tyre 809 ose 93.74%, janë parashtruar nga ankuesit e përkatësisë etnike shqiptare, ndërsa 50 ankesa ose 5.79%, janë parashtruar nga ankuesit e përkatësisë etnike serbe, 2 ankesa ose 0.23% janë parashtruar nga ankuesit e përkatësisë etnike boshnjake, dhe 2 ankesa ose 0.23% janë parashtruar nga ankuesit e përkatësisë etnike turke.

Nr.rendor	Ankesat e pranuar sipas strukturës etnike të ankuesve	Numri i ankesave	Përqindja
1	Shqiptar	809	93.74%
2	Serb	50	5.79%
3	Boshnjak	2	0.23%
4	Turk	2	0.23%

Tabela nr. 3 paraqet ankesat e pranuar sipas strukturës etnike të ankuesve




Diagrami nr.3 paraqet të dhënat e tabelës nr.3

5.1.4. Ankesat e pranuar sipas institucioneve kundër vendimeve të cilave është paraqitur ankesë

Këshilli, gjatë periudhës raportuese ka pranuar ankesa nga nëpunësit civilë dhe nga kandidatët për pranim në shërbimin civil, të parashtruara kundër vendimeve të organeve të punësimit, si në vijim: 560 ankesa ose 64.88% e numrit të përgjithshëm të ankesave janë parashtruar kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore si dhe 303 ankesa ose 35.12% e numrit të përgjithshëm të ankesave janë parashtruar kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale.

Nr.	Ankesat e pranuar sipas institucioneve kundër vendimeve të cilave është paraqitur ankesë	Numri i ankesave	Përqindja
1	Institucionet e administratës qendrore	560	64.88%
2	Institucionet e administratës lokale	303	35.12%

Tabela nr. 4 paraqet ankesat e pranuar sipas institucioneve kundër vendimeve të cilave është paraqitur ankesë.



Diagrami nr. 4 paraqet të dhënat e tabelës nr.4

6. ANKESAT E PRANUARA KUNDËR VENDIMEVE TË INSTITUCIONEVE

6.1. Ankesat kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore

Këshilli, gjatë periudhës raportuese ka pranuar 560 ankesa kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore, të cilat pasqyrohen si në vijim:

Nr.	Institucionet e Administratës Qendrore	Numri i Ankesave	Përqindja
1	Universiteti i Prishtinës	40	4.60%
2	Administrata Tatimore e Kosovës	34	3.94 %
3	Policia e Kosovës	30	3.47%
4	Ministria e Punëve të Brendshme	27	3.13%
5	Universiteti i Mitrovicës	27	3.13%
6	Këshilli Prokurorial i Kosovës	23	2.7%
7	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	23	2.7%
8	Ministria e Shëndetësisë	22	2.55%
9	Ministria e Administratës Publike	18	2.08%
10	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	17	1.97%
11	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	16	1.85%
12	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	16	1.85%
13	Ministria e Infrastrukturës	14	1.62%
14	Agjencia Kosovare e Privatizimit	14	1.62%
15	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës	14	1.62%
16	Gjykata Themelore në Gjakovë	13	1.50%
17	Ministria e Punëve të Jashtme	12	1.4%
18	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	12	1.4%
19	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	12	1.4%
20	Shërbimi Korrektues i Kosovës	9	1.04%
21	Gjykata Themelore në Prishtinë	9	1.04%
22	Institucioni i Avokatit të Popullit	8	0.93%
23	Agjencia e Statistikave të Kosovës	7	0.81%
24	Kuvendi i Republikës së Kosovës	6	0.7%
25	Gjykata e Apelit	6	0.7%
26	Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore	6	0.7%
27	Universiteti i Prizrenit	6	0.7%
28	Gjykata Themelore në Mitrovicë	6	0.7%
29	Agjencia Pyjore e Kosovës	6	0.7%
30	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	5	0.58%
31	Gjykata Supreme e Kosovës	5	0.58%
32	Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë	5	0.58%
33	Ministria e Financave	5	0.58%
34	Ministria e Drejtësisë	5	0.58%
35	Gjykata Themelore në Ferizaj	5	0.58%
36	Dogana e Kosovës	5	0.58%
37	Gjykata Themelore në Pejë	4	0.46%

38	Ministria e Integritimeve Evropiane	4	0.46%
39	Universiteti i Gjilanit	4	0.46%
40	Agjencia Kosovare e Pronës	4	0.46%
41	Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike	3	0.35%
42	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	3	0.35%
43	Gjykata Themelore në Gjilan	3	0.35%
44	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	3	0.35%
45	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	3	0.35%
46	Qendra Klinike Universitare	3	0.35%
47	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas	3	0.35%
48	Zyra e Kryeministrit	2	0.23%
49	Ministria e Zhvillimit Rajonal	2	0.23%
50	Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë	2	0.23%
51	Instituti i Historisë	2	0.23%
52	Autoriteti Rregullativ për Shërbimet e Ujit	2	0.23%
53	Biblioteka Kombëtare e Kosovës	2	0.23%
54	Prokuroria e Shtetit	2	0.23%
55	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	2	0.23%
56	Këshilli i Sigurisë së Kosovës	2	0.23%
	Agjencia e Punësimit	2	0.11%
57	Universiteti i Pejës	1	0.12%
58	Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës	1	0.12%
59	Qendra e Studentëve të Universitetit të Prishtinës	1	0.12%
60	Autoriteti Rregullativ për Komunikime Elektronike	1	0.12%
61	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike	1	0.12%
62	Ministria e FSK-së	1	0.12%
63	Agjencia Kundër Korrupsionit	1	0.12%
64	Gjykata Themelore në Prizren	1	0.12%
65	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Gjakovë	1	0.12%
66	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Ferizaj	1	0.12%
67	Agjencia Kosovare për Produkte Medicinale	1	0.12%
68	Zyra Kombëtare e Auditimit	1	0.12%
69	Autoriteti i Aviacionit Civil	1	0.12%
71	Prokuroria Themelore në Ferizaj	1	0.12%
72	Prokuroria Themelore në Gjakovë	1	0.12%
	Gjithsejt:	560	64.88%

Tabela nr. 5 paraqet të dhënat për numrin dhe përqindjen e ankesave të arritura në Këshill, gjatë vitit 2018, kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore.

Ankesat e pranuar kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore sipas objektit të ankesës	Kategoria e Ankesës														
	Kontestim konkursi	Kërkesa nga marrëdhënia e Punës	Transferim	Kompensim material	Masë disiplinore	Ndërpreje e marrëdhënies së punës	Pezullim parandalues	Mos ekzekutim i vendimit të Komisionit të Ankesave	Vlerësim i punës	Shkelje e të drejtës në pagë	Ulje në pozitë	Çështje e avancimit në karrierë	Mos vazhdim i kontratës së punës	Kundër caktimit të ushtruesit të detyrës	Gjithsejtë
Universiteti i Prishtinës	2			38											40
Administrata Tatimore e Kosovës	14	3	7	2	5	1				2					34
Policia e Kosovës		2		3	14	8		1	1		1				30
Ministria e Punëve të Brendshme	16			7	1	2							1		27
Universiteti i Mitrovicës	1	6		20											27
Këshilli Prokurorial i Kosovës	20					1			1				1		23
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	7	5	1	4		2		1	3						23
Ministria e Shëndetësisë	7	1	2	1	1	5	3	2							22
Ministria e Administratës Publike	13	1		3	1										18
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	7	1			4	4		1							17
Ministria e Arsimit,	4	5		4		1							2		16

Shkencës dhe Teknologjisë																				
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	8	1	1	2	2	2														16
Ministria e Infrastrukturës	6	1	1	1		1		1	1								2			14
Agjencia Kosovare e Privatizimit	3	3		2	1	3					1	1								14
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës	3	6	1			2											2			14
Gjykata Themelore në Gjakovë	12			1																13
Ministria e Punëve të Jashtme	9	1											2							12
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	5			1	5						1									12
Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	3	1		3	1											2	2			12
Shërbimi Korrektues i Kosovës	4	3		2																9
Gjykata Themelore në Prishtinë	5	1		3																9
Institucioni i Avokatit të Popullit	7			1																8
Agjencia e Statistikave të Kosovës	3	1				1				2										7
Kuvendi i Republikës së Kosovës	4	1			1															6
Gjykata e Apelit	2	1		1		2														6
Këshilli i Kosovës për Trashëgimi	2				1		1		2											6

Kulturore																						
Universiteti i Prizrenit	6																					6
Gjykata Themelore në Mitrovicë	5						1															6
Agjencia Pyjore e Kosovës	2		1		3																	6
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	3					1		1														5
Gjykata Supreme e Kosovës	1		1	2							1											5
Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë	2	1		1			1															5
Ministria e Financave	1			2				1		1												5
Ministria e Drejtësisë	1			4																		5
Gjykata Themelore në Ferizaj	3									2												5
Dogana e Kosovës	1	2		1	1																	5
Gjykata Themelore në Pejë				3			1															4
Ministria e Integrimeve Evropiane	1	1						1													1	4
Universiteti i Gjilanit	4																					4
Agjencia Kosovare e Pronës				2	1						1											4
Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike	2							1														3
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	2							1														3
Gjykata Themelore në	3																					3

Gjilan															
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	1				1				1						3
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	2		1												3
Qendra Klinike Universitare	2			1											3
Agjencia për Ndihmë Juridike Falas	1		1	1											3
Zyra e Kryeministrit	2														2
Ministria e Zhvillimit Rajonal	2														2
Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë	2														2
Instituti i Historisë	2														2
Autoriteti Rregullativ për Shërbimet e Ujit	2														2
Biblioteka Kombëtare e Kosovës	2														2
Prokuroria e Shtetit	1				1										2
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	1												1		2
Këshilli i Sigurisë së Kosovës				2											2
Agjencia e Punësimit	2														2
Universiteti i Pejës	1														1
Agjencia Shtetërore e Akivava të Kosovës	1														1
Qendra e Studentëve të	1														1

Universitetit të Prishtinës															
Autoriteti Rregullativ për Komunikime Elektronike			1												1
Instituti Kombëtarë i Shëndetësisë Publike	1														1
Ministria e Forcës së Sigurisë	1														1
Agjencia Kundër Korrupsionit									1						1
Gjykata Themelore në Prizren				1											1
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Gjakovë	1														1
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Ferizaj					1										1
Agjencia Kosovare për Produkte							1								1
Zyra Kombëtare e Auditimit	1														1
Autoriteti i Aviacionit Civil					1										1
Prokuroria Themelore në Ferizaj	1														1
Prokuroria Themelore në Gjakovë	1														1
Gjithsejt:	235	48	18	119	46	36	10	6	10	12	3	3	3	11	560

Tabela nr.6 paraqet ankesat e pranuar kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore, sipas objektit të ankesave

6.2. Ankesat kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka pranuar 303 ankesa të cilat janë parashtruar kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale, e të cilat pasqyrohen si në vijim.

Nr.	Institucionet e administratës	Numri i ankesave	Përqindja
1	Komuna e Leposaviqit	33	3.82%
2	Komuna e Ferizajt	30	3.47%
3	Komuna e Gjakovës	24	2.78%
4	Komuna e Prizrenit	23	2.66%
5	Komuna e Mitrovicës	20	2.31%
6	Komuna e Drenasit	19	2.20%
7	Komuna e Prishtinës	16	1.85%
8	Komuna e Podujevës	15	1.74%
9	Komuna e Kamenicës	14	1.62%
10	Komuna e Gjilanit	12	1.39%
11	Komuna e Vushtrrisë	11	1.27%
12	Komuna e Klllokotit	11	1.27%
13	Komuna Skenderajt	11	1.27%
14	Komuna e Vitisë	9	1.04%
15	Komuna e Pejës	8	0.92%
17	Komuna e Istogut	7	0.81%
18	Komuna e Rahovecit	6	0.81%
19	Komuna e Klinës	5	0.57%
20	Komuna e Kaçanikut	5	0.57%
21	Komuna e Suharekës	4	0.46%
22	Komuna e Dragashit	3	0.34%
23	Komuna e Malishevës	3	0.34%
24	Komuna e Fushë Kosovës	3	0.34%
25	Komuna e Obiliqit	3	0.34%
26	Komuna e Shtimes	3	0.34%
27	Komuna e Deçanit	2	0.23%
28	Komuna e Zubin Potokut	1	0.12%
29	Komuna e Shtërpçës	1	0.12%
30	Komuna e Parteshit	1	0.12%
	Gjithsejtë:	303	35.12%

Tabela nr.7 Paraqet të dhënat për numrin dhe përqindjen e ankesave të arritura në Këshill, gjatë vitit 2018, kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale

Ankesat e pranuar kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale sipas objektit të ankesave	Kontestim konkursi	Kompensim material	Ndërpreje e marrëdhënies së punës	Transferim	Masë disiplinore	Pezullim parandalues	Shkelje e të drejtës në pagë	Kërkesa nga marrëdhënia e punës	Kundër caktimit të ushtruesit të detyrës	Çështje e avancimit në karrierë	Mos ekzekutim i vendimit të Komisionit të Ankesave	Gjithsejtë
Komuna e Leposaviqit	1	12	20									33
Komuna e Ferizajt	10	3	7	4	3	1		2				30
Komuna e Gjakovës	16	1		1	2		1	3				24
Komuna e Prizrenit	13	3					1	4			2	23
Komuna e Mitrovicës	13	3		1				2			1	20
Komuna e Drenasit	5	5	1		1	3		3			1	19
Komuna e Prishtinës	4	3	3		1			5				16
Komuna e Podujevës	7	8										15
Komuna e Kamenicës	7	1	1	1	2	1	1					14
Komuna e Gjilanit	10	1		1								12
Komuna e Vushtrrisë	2	1	1	1			2	3		1		11
Komuna e Klllokotit			6		3			2				11
Komuna Skenderajt	4		5		1	1						11
Komuna e Vitisë	3				1		5					9
Komuna e Pejës	5	1				2						8
Komuna e Istogut	7											7

Komuna e Rahovecit	4	1			1							6
Komuna e Klinës	5											5
Komuna e Kaçanikut	4							1				5
Komuna e Suharekës	1		1					2				4
Komuna e Dragashit	2						1					3
Komuna e Malishevës	3											3
Komuna e Fushë Kosovës	2	1										3
Komuna e Obiliqit			2					1				3
Komuna e Shtimes			1		1	1						3
Komuna e Deçanit	2											2
Komuna e Zubin Potokut	1											1
Komuna e Shtërpcës									1			1
Komuna e Parteshit				1								1
Gjithsejt:	131	44	48	10	16	9	11	28	1	1	4	303

Tabela nr.8 paraqet ankesat e pranuar kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale sipas objektit të ankesave

7. NDARJA E ANKESAVE SIPAS MËNYRËS SË VENDOSJES

Këshilli, gjatë vitit 2018, ka shqyrtuar dhe ka vendosur për gjithsej 825 ankesa, si në vijim:

7.1 Të aprovuara

Janë ankesat e parashtruara nga ankuesit, që në bazë të provave dhe fakteve, Këshilli i ka aprovuar dhe ka anuluar vendimet e organeve të punësimit, duke i obliguar organet e punësimit për zbatimin e vendimeve të Këshillit në afatin e përcaktuar ligjor.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka aprovuar (149) ankesa.

7.2 Pjesërisht të aprovuara

Janë ankesat e parashtruara nga ankuesit të cilat kanë dy e më shumë pretendime ankimore dhe për të cilat Këshilli në bazë të provave dhe fakteve të ofruara nga ankuesit dhe nga organet e punësimit ka vendosur për aprovimin e pjesërisht të ankesës.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka aprovuar pjesërisht (11) ankesa.

7.3 Të refuzuara

Janë ankesat e parashtruara nga ankuesit, të cilat Këshilli i ka refuzuar si të pabazuara në bazë të provave dhe fakteve të paraqitura nga ankuesit dhe organet e punësimit, duke lënë në fuqi vendimet e organeve të punësimit.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka refuzuar (332) ankesa.

7.4 Të hedhura poshtë si të palejuara

Janë ankesat e parashtruara nga ankuesit, të cilat Këshilli i ka hedhë poshtë si të palejuara sepse nuk janë shterur mjetet e brendshme të ankimit, janë parashtruar jashtë afatit të përcaktuar ligjor për ankim, apo janë parashtruar nga personat që në bazë të ligjit nuk konsiderohen palë në procedurë. Këshilli gjatë periudhës raportuese ka hedhur poshtë si të palejuara (116) ankesa.

7.5 Të shpallura jo-kompetent

Janë ankesat e parashtruara nga ankuesit për të cilat Këshilli ka vendosur që të shpallet jo-kompetent, për shkak se ankesat janë parashtruar nga personat të cilët nuk e kanë statusin e nëpunësit civil ose nuk janë kandidatë për pranim në shërbimin civil.

Këshilli gjatë periudhës raportuese është shpallur jo kompetent për (47) ankesa.

7.6 Detyrimi i organit administrativ për të nxjerr aktin administrativ

Janë vendime me të cilat Këshilli i detyron organet e punësimit, respektivisht komisionet përkatëse për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave për të vendosur për ankesën e ankuesit, në rastet kur nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka nxjerr vendime për detyrimin e organeve të punësimit për të vendosur, për (59) ankesa.

7.7 Kthimi në rishqyrtim

Janë vendime me të cilat, Këshilli ka vendos për kthimin e lëndës në rishqyrtim tek organet e punësimit për të gjitha rastet kur në bazë të provave dhe fakteve të ofruara nga ankuesit dhe nga organet e punësimit, Këshilli ka konstatuar se nëse lënda kthehet në rishqyrtim tek organi i punësimit do të evitohen gabimet të cilat nuk konsiderohen si shkelje të rënda procedurale. Këshilli gjatë periudhës raportuese ka vendosur për kthimin e lëndës në rishqyrtim për **(67)** ankesa.

7.8 Përfundim i procedimit administrativ

Janë vendime të cilat Këshilli i nxjerr për të gjitha rastet kur ankuesit i tërheqin ankesat ose kur Këshilli konstaton se objekti për të cilin kishte filluar procedimi ose qëllimi i vendimit është bërë i pamundur

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka vendosur për përfundimin e procedimit administrativ për **(44)** ankesa.

Në tabelën në vijim paraqitet në mënyrë tabelare, mënyra e vendosjes nga Këshilli për **825** ankesa, numri i ankesave të vendosura si dhe përqindja në krahasim me numrin e përgjithshëm të ankesave të vendosura.

Mënyra e vendosjes	Numri i ankesave	Përqindja
Të refuzuara	332	40.24%
Të aprovuara	149	18.06%
Të hedhura poshtë si të palejuara	116	14.06%
Kthimi në rishqyrtim	67	8.12%
Detyrim për vendosje	59	7.15%
Shpallja jo kompetent	47	5.7%
Përfundim i procedimit administrativ	44	5.33%
Të aprovuara pjesërisht	11	1.33%
Gjithsejtë	825	100%

Tabela nr. 9 paraqet mënyrën e vendosjes së ankesave nga Këshilli, numrin e ankesave sipas mënyrës së vendosjes dhe përqindjen në krahasim me numrin e përgjithshëm të ankesave



Diagrami nr. 5 paraqet të dhënat e tabelës nr.9

8. FORMAT E VENDOSJES KUNDËR VENDIMEVE TË INSTITUCIONEVE

Në këtë pjesë të raportit, paraqiten të dhënat për formën e vendosjes nga Këshilli, lidhur me ankesat e parashtruara kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore dhe lokale.

8.1 Format e vendosjes kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore

Këshilli, gjatë periudhës raportuese ka vendosur për **539** ankesa të parashtruara kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore, gjegjësisht për **494** ankesa të vitit 2018 , dhe për **45** ankesa të bartura nga viti 2017 në vitin 2018.

Institucionet e Administratës Qendrore	Të aprovuara	Të refuzuara	Pjesërisht të aprovuara	Të hedhura poshtë si të palejuara	Shpallja jo kompetent	Kthimi në rishqyrtim	Përfundim i procedimit administrativ	Detyrimi i organit administrativ për të nxjerr aktin administrativ	Numri i ankesave të shqyrtuara
Universiteti i Prishtinës		1	1	18				18	38
Administrata Tatimore e Kosovës	16	8		2		5	4	1	36
Policia e Kosovës	6	10		2	2	10	1		31
Universiteti i Mitrovicës				9	7		10		26
Ministria e Punëve të Brendshme	2	9		2	3	4	4		24
Ministria e Administratës Publike	8	5		4		4	1	2	24
Këshilli Prokurorial i Kosovës	2	17	2	1	1				23
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	1	7		5	5		2	1	21
Ministria e Shëndetësisë	3	6	1	1	1	2	1	5	20
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	2	9	1	1	3	2	1		19
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	1	10				5			16
Ministria e Infrastrukturës	8	4		2					14
Gjykata Themelore në Gjakovë	2	10		1					13
Ministria e Punëve të Jashtme	3	6				2		1	12
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	1	2		1	1	6		1	12
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës		4	1	6		1			12
Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës		6		1	1	2	1		11
Agjencia Kosovare e Privatizimit		7	1	1		2			11
Shërbimi Korrektues i Kosovës		2		1	2	3	1	1	10
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	4	4						2	10
Gjykata Themelore në Prishtinë	1	6		1				1	9
Gjykata Themelore në Mitrovicë	3	2				2		1	8
Institucioni i Avokatit të Popullit	4			3		1			8
Ministria e Drejtësisë		3	1	3			1		8
Kuvendi i Kosovës		4		2		1			7
Universiteti i Prizrenit		5		1			1		7

Dogana e Kosovës	1	3		2					6
Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore	2	2					1	1	6
Agjencia e Statistikave të Kosovës	2	2			1	1			6
Gjykata e Apelit		3				2			5
Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë	1	2		1					4
Gjykata Themelore në Pejë		4							4
		<p>Avdyl Frashëri</p> <p>19. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Lekë Dukagjini”</p> <p>20. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Motrat Qiriazi”</p> <p>21. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Fadil Hisari”</p> <p>22. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët Mati Logoreci</p> <p>23. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Ibrahim Fehmiu”</p> <p>24. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Zef Lush Marku”</p> <p>25. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “22 Dëshmorët”</p> <p>26. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Lidhja e Prizrenit”</p> <p>27. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Motrat Qiriazi”</p> <p>28. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Dëshmorët e Zhurit”</p> <p>29. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Sinan Thaqi”</p>	<p>V.Nr.301/2018</p> <p>V.Nr.301/2018</p> <p>V.Nr.299/2018</p> <p>V.Nr.299/2018</p> <p>V.Nr.297/2018</p> <p>V.Nr.297/2018</p> <p>V.Nr.299/2018</p> <p>V.Nr.296/2018</p> <p>V.Nr.296/2018</p> <p>V.Nr.296/2018</p> <p>V.Nr.296/2018</p>	
2	Komuna e Drenasit	<p>1. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Arif Shala”</p> <p>2. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “7 Marsi”</p> <p>3. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Dëshmoret e Drenicës”</p> <p>4. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët Mehmet Gradica</p> <p>5. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Ali Gashi”</p> <p>6. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Hasan Prishtina”</p> <p>7. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Shaban Polluzha”</p> <p>8. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Dëshmoret e Fortesës”</p> <p>9. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Migjeni”</p> <p>10. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Naim Frashëri”</p> <p>11. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “24 Korriku”</p>	<p>V.Nr.319/2017</p> <p>V.Nr.318/2017</p> <p>V.Nr.8/2018</p> <p>V.Nr.319/2017</p> <p>V.Nr.319/2017</p> <p>V.Nr.323/2017</p> <p>V.Nr.322/2017</p> <p>V.Nr.316/2017</p> <p>V.Nr.320/2017</p> <p>V.Nr.326/2017</p> <p>V.Nr.261/2018</p>	17

		<p>12. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Jusuf Gërvalla”</p> <p>13. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Azem Bejta”</p> <p>14. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Rilindja”</p> <p>15. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Gjeladin Gashi-Plaku”</p> <p>16. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Rasim Kiqina”</p> <p>17. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Shaban Polluzha”</p>	<p>V.Nr.262/2018</p> <p>V.Nr.263/2018</p> <p>V.Nr.264/2018</p> <p>V.Nr.261/2018</p> <p>V.Nr.267/2018</p> <p>V.Nr.223/2017</p>	
3	Komuna e Mitrovicës	<p>1. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Shabani Idrizi”</p> <p>2. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Elena Gjika”</p> <p>3. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Bislim Halimi”</p> <p>4. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Bislim Hajdari”</p> <p>5. Zëvendës Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Migjeni”</p> <p>6. Zëvendës Drejtor i Shkollës së Mesme të Lartë “Hasan Prishtina”</p> <p>7. Menaxher i Personelit</p> <p>8. Udhëheqës i Sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit</p> <p>9. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Gjeladin Deda”</p> <p>10. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët Musa Hoti</p> <p>11. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Bislim Halimi”</p> <p>12. Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare</p> <p>13. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Mehe Uka”</p>	<p>V.Nr.34/2018</p> <p>V.Nr.32/2018</p> <p>V.Nr.31/2018</p> <p>V.Nr.30/2018</p> <p>V.Nr.30/2018</p> <p>V.Nr.30/2018</p> <p>V.Nr.61/2018</p> <p>V.Nr.100/2018</p> <p>V.Nr.31/2018</p> <p>V.Nr.31/2018</p> <p>V.Nr.30/2018</p> <p>V.Nr.30/2018</p> <p>V.Nr.33/2018</p>	13
4	Komuna e Klinës	<p>1. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Motrat Qiriazhi”</p> <p>2. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Gjergj Fishta”</p> <p>3. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Dëshmorët e Kombit”</p> <p>4. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Ymer Berisha”</p>	<p>V.Nr.56/2018</p> <p>V.Nr.57/2018</p> <p>V.Nr.58/2018</p> <p>V.Nr.168/2018</p>	11

		<p>5. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Isa Boletini”</p> <p>6. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Shtjefën Gjeqovi”</p> <p>7. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Avni Zhabota”</p> <p>8. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Tre Dëshmorët”</p> <p>9. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Ismet Rraci”</p> <p>10. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Nëna Terezë”</p> <p>11. Drejtor i Qendrës për Punë Sociale</p>	<p>V.Nr.169/2018</p> <p>V.Nr.170/2018</p> <p>V.Nr.171/2018</p> <p>V.Nr.172/2018</p> <p>V.Nr.184/2018</p> <p>V.Nr.219/2018</p> <p>V.Nr.253/2018</p>	
5	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	<p>1. Udhëheqës i Zyrës së Pensioneve në Prishtinë</p> <p>2. Udhëheqës i Departamentit të Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës</p> <p>3. Drejtor i Departamentit Ligjor</p> <p>4. Drejtor i Departamentit të Tregut</p> <p>5. Udhëheqës i Zyrës së Pensioneve në Prizren</p> <p>6. Udhëheqës i Divizionit të Teknologji Informative dhe Logjistikës</p> <p>7. Udhëheqës i Departamentit për Shërbimet të Aftësimit Profesional</p>	<p>V.Nr.9/2018</p> <p>V.Nr.28/2018</p> <p>V.Nr.53/2017</p> <p>V.Nr.216/2018</p> <p>V.Nr.342/2018</p> <p>V.Nr.387/2018</p> <p>V.Nr.444/2018</p>	7
6	Ministria e Punëve të Brendshme	<p>1.Udhëheqës i Qendrës për Regjistrim të Automjeteve në Gjakovë</p> <p>2. Udhëheqës i Divizionit për Administrim të Sistemeve dhe Rrjetit</p> <p>3. Udhëheqës i Qendrës për mbajtjen e të Huajve</p> <p>4. Drejtor i Drejtorisë për Prodhimin e Dokumenteve</p> <p>5. Drejtor i Departamentit për Integritet Evropiane dhe Koordinim të Politikave</p> <p>6. Udhëheqës i Divizionit për riparim dhe Kthim në DASHM</p> <p>7. Udhëheqës i Divizionit për Koordinim të Politikave në DIEKP</p>	<p>V.Nr.208/2018</p> <p>V.Nr.379/2018</p> <p>V.Nr.381/2018</p> <p>V.Nr.339/2017</p> <p>V.Nr.338/2017</p> <p>V.Nr.47/2017</p> <p>V.Nr.46/2017</p>	7
7	Komuna e Gjakovës	<p>1.Drejtor i Teatrit të Qytetit</p> <p>2.Menaxher i Personelit</p> <p>3.Zv. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Zekirja Rexha”</p> <p>4. Udhëheqës i Sektorit Ligjor</p>	<p>V.Nr.327/2017</p> <p>V.Nr.53/2018</p> <p>V.Nr.60/2018</p> <p>V.Nr.88/2018</p>	6

		5. Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Profesionale	V.Nr.112/2018	
		6. Udhëheqës i Sektorit për Inspektive	V.Nr.242/2018	
8	Komuna e Pejës	1. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Zef Serembe” 2. Drejtor i Shkollës së Mesme të Teknike “Shaban Spahija” 3. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Pjetër Budi” 4. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “28 Nëntori” 5. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Dardania” 6. Drejtor i Shkollës së Mesme Ekonomike “Ali Hadri”	V.Nr.24/2018 V.Nr.26/2018 V.Nr.270/2018 V.Nr.271/2018 V.Nr.272/2018 V.Nr.386/2018	6
9	Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë	1. Drejtor i Departamentit për Teknologji Informative 2. Drejtor i Drejtorisë për Administratë 3. Drejtor i Drejtorisë së Pagesave Direkte 4. Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit 5. Drejtor i Drejtorisë për Autorizimin e Pagesave 6. Drejtor i Drejtorisë për Miratimin e Projekteve të Zhvillimit Rural	V.Nr.346/2017 V.Nr.3/2017 V.Nr.350/2017 V.Nr.124/2018 V.Nr.125/2018 V.Nr.126/2018	6
10	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	1. Drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës 2. Drejtor i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve 3. Drejtor i Ansambllit Kombëtarë të Këngëve dhe Valleve Shota 4. Drejtor në Departamentin e Kulturës 5. Udhëheqës i Divizionit për Mbikëqyrjen dhe zbatimin të Legjislacionit	V.Nr.12/2018 V.Nr.114/2018 V.Nr.287/2018 V.Nr.328/2018 V.Nr.337/2018	5
11	Administrata Tatimore e Kosovës	1. Drejtor i Drejtorisë Rajonale 2. Drejtor i Departamentit të Lojërave të Fatit 3. Udhëheqës i Divizionit të Trajnimeve 4. Drejtor i Departamentit të Burimeve Njerëzore 5. Udhëheqës i Divizionit për Procedurat e Mbledhjes	V.Nr.116/2018 V.Nr.121/2018 V.Nr.221/2018 V.Nr.314/2018 V.Nr.440/2018	5
12	Ministria e Drejtësisë	1. Udhëheqës i Divizionit për Komunikim me Publikun 2. Drejtor i Drejtoratit për Ekzekutimin e	V.Nr.98/2018 V.Nr.132/2018	5

		Masave dhe Dënimeve Alternative 3. Udhëheqës i Divizionit për Bashkëpunim në çështjen Penale dhe Civile 4. Udhëheqës i Zyrës Rajonale 5. Udhëheqës i Divizionit për Jurisprudencë	V.Nr.182/2018 V.Nr.193/2018 V.Nr.329/2018	
13	Agjencia e Punësimit	1. Menaxher i Personelit 2. Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin e Masave Aktive dhe Analizave në Tregun e Punës 3. Udhëheqës i Zyrës së Punësimit në Vushtri 4. Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme 5. Drejtor i Departamentit për Aftësim Profesional	V.Nr.306/2018 V.Nr.307/2018 V.Nr.348/2018 V.Nr.351/2018 V.Nr.376/2018	5
14	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	1. Drejtor i Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtarë Sharri 2. Udhëheqës i Sektorit për Sistemin e Informimit Mjedisor 3. Udhëheqës i Divizionit për Gis 4. Udhëheqës i Autoritetit Rajonal të Pellgjeve lumore 5. Drejtor i Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtarë Sharri	V.Nr.6/2018 V.Nr.157/2018 V.Nr.241/2018 V.Nr.335/2018 V.Nr.33/2018	5
15	Ministria e Financave	1. Udhëheqës i Divizionit për Koordinim të Politikave 2. Udhëheqës i Divizionit për Integrim Evropian 3. Udhëheqës i Divizionit për Borxhe 4. Udhëheqës i Divizionit për Kontabilitet dhe Barazime 5. Udhëheqës i Divizionit për Inspektim	V.Nr.144/2018 V.Nr.145/2018 V.Nr.343/2018 V.Nr.345/2018 V.Nr.388/2018	5
16	Komuna e Kaçanikut	1. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Jusuf Gërvalla” 2. Udhëheqës i Sektorit Ligjor 3. Drejtor i Qendrës për Punë Sociale 4. Udhëheqës i Sektorit të Gjendjes Civile	V.Nr.39/2018 V.Nr.202/2018 V.Nr.374/2018 V.Nr.375/2018	4
17	Autoriteti Kosovarë i Konkurrencës	1. Udhëheqës i Divizionit të Pozitës Dominuese 2. Udhëheqës i Divizionit për Marrëveshje të ndaluara 3. Udhëheqës i Divizionit të Përqendrimeve dhe Bashkimeve 4. Udhëheqës i Divizionit të Analizës,	V.Nr.365/2018 V.Nr.366/2018 V.Nr.367/2018 V.Nr.368/2018	4

		Metodologjisë dhe të drejtave Ekskluzive		
18	Komuna e Vitisë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Kenan Halimi” 2. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Nazmi Pajaziti” 3. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Ndre Mjeda” 4. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Ahmet Hajdari” 	<p>V.Nr.159/2018</p> <p>V.Nr.173/2018</p> <p>V.Nr.174/2018</p> <p>V.Nr.347/2018</p>	4
19	Këshilli Prokurorial i Kosovës	<ol style="list-style-type: none"> 1.Udhëheqës i Divizionit për Administratë. 2. Udhëheqës i Zyrës për Administrim të Dokumenteve dhe Arkivim 3. Udhëheqës i Burimeve Njerzore 4.Administrator i prkuris Speciale 	<p>V.Nr.106/2018</p> <p>V.Nr.358/2018</p> <p>V.Nr.349/2017</p> <p>V.Nr.277/2017</p>	4
20	Ministria e Zhvillimit Rajonal	<ol style="list-style-type: none"> 1. Drejtor i Departamentit për Planifikim dhe Analiza Socio-Ekonomike rajonale 2. Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa 2. Udhëheqës i Divizionit për Koordinim të Politikave 3. Udhëheqës i Divizionit për Menaxhim të Projekteve 	<p>V.Nr.282/2018</p> <p>V.Nr.288/2018</p> <p>V.Nr.325/2018</p> <p>V.Nr.369/2018</p>	4
21	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës	<ol style="list-style-type: none"> 1.Drejtor i Laboratorit të Ushqimit dhe Veterinarisë 2. Udhëheqës i Sektorit të Administratës 3. Udhëheqës i Sektorit të Mbetjeve në Ushqim 	<p>V.Nr.45/2018</p> <p>V.Nr.317/2018</p> <p>V.Nr.384/2018</p>	3
22	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	<ol style="list-style-type: none"> 1.Udhëheqës i Sektorit për metale të Çmuara 2. Drejtor i Departamentit për Kontrollin e Tregut me Mallra Strategjike 3. Udhëheqës i Divizionit për Integrim Evropian 	<p>V.Nr.133/2018</p> <p>V.Nr.166/2018</p> <p>V.Nr.198/2018</p>	3
23	Ministria e Administratës Publike	<ol style="list-style-type: none"> 1.Menaxher i Personelit 2. Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin e Politikave Reformuese dhe Mbikëqyrje të Organizatave të Brendshme Institucionale 3. Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Burimeve Njerzore 	<p>V.Nr.17/2018</p> <p>V.Nr.79/2018</p> <p>V.Nr.183/2018</p>	3
24	Agjencia e Statistikave të	<ol style="list-style-type: none"> 1. Udhëheqës i Divizionit të Normalitetit dhe Llogarive Qeveritare 	<p>V.Nr.175/2018</p>	3

	Kosovës	2. Drejtor i Departamentit të Llogarive Kombëtare 3. Udhëheqës i Zyrës Rajonale të Statistikave në Prizren	V.Nr.377/2018 V.Nr.356/2017	
25	Agjencia Pyjore e Kosovës	1. Drejtor i Drejtorisë Koordinuese të Zyrës regjionale në Prishtinë 2. Udhëheqës i Sektorit për Silvikulturë Shfrytëzim Mbrojtje dhe Monitorim të Pyjeve 3. Udhëheqës i Sektorit për Hulumtim dhe legjislacion	V.Nr.306/2018 V.Nr.330/2018 V.Nr.357/2018	3
26	Agjencia Kosovare e Privatizimit	1. Drejtor i Departamentit për Buxhet dhe Financa 2. Drejtor i Komisioneve Profesionale 3. Drejtor i Departamentit të Marketingut dhe Marrëdhënieve me Investitor	V.Nr.165/2018 V.Nr.238/2018 V.Nr.289/2018	3
27	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	1. Menaxher i Personelit 2. Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Pyjeve Inventarizim dhe Infrastrukturë në Pylltari 3. Udhëheqës i Divizionit për Këshilla Teknike	V.Nr.336/2018 V.Nr.355/2018 V.Nr.353/2017	3
28	Komuna e Podujevës	1. Udhëheqës i Sektorit Ligjor 2. Udhëheqës i Sektorit për Gjendje Civile 3. Udhëheqës i Sektorit për Çështje Pronësorë Juridike	V.Nr.36/2018 V.Nr.209/2018 V.Nr.210/2018	3
29	Komuna e Vushtrrisë	1. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Andon Zako Çajupi” 2. Drejtor i Shkollës së Mesme Teknike “Lutfi Musiqi” 3. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “SHMU2”	V.Nr.128/2018 V.Nr.200/2018 V.Nr.201/2018	3
30	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	1. Udhëheqës i Divizionit të Resurseve Minerale dhe Bilanc 2. Udhëheqës i Sektorit për Planifikim 3. Drejtor i Departamentit Ligjor	V.Nr.230/2018 V.Nr.290/2018 V.Nr.309/2018	3
31	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	1. Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa 2. Drejtor i Departamentit për Bashkëpunim dhe Zhvillim 3. Udhëheqës i Divizionit për Integrim Evropian	V.Nr.94/2018 V.Nr.233/2018 V.Nr.338/2018	3
32	Universiteti i Prizrenit	1. Sekretar i Njësisë Akademike Fakulteti Juridik 2. Sekretar i Njësisë Akademike Fakulteti	V.Nr.278/2018 V.Nr.279/2018	3

		i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit 3. Sekretar i Njesisë Akademike Fakulteti Filologjik	V.Nr.277/2018	
33	Ministria e Infrastrukturës	1.Drejtor i Departamentit Ligjor 2. Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme	V.Nr.354/2018 V.Nr.407/2018	2
34	Universiteti i Gjilanit	1.Drejtor i Zyrës për Shkencë, Zhvillim Akademik dhe Cilësi 2. Drejtor i Zyrës për Buxhet dhe Financa	V.Nr.105/2018 V.Nr.104/2018	2
35	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit	1. Drejtor i Departamentit për Tarifa 2. Drejtor i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Licencim	V.Nr.64/2018 V.Nr.206/2018	2
36	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas	1. Drejtor i Departamentit Ligjor 2. Udhëheqës i Divizionit për Harmonizim dhe legjislacion	V.Nr.18/2018 V.Nr.234/2018	2
37	Universiteti i Mitrovicës	1.Sekretar i Njesisë Akademike Fakulteti Juridik 2. Sekretar i Njesisë Akademike Fakulteti i Gjeoshkencave	V.Nr.97/2018 V.Nr.96/2018	2
38	Zyra e Kryeministrit	1.Drejtor i Zyrës për Planifikim Strategjik 2. Udhëheqës i Divizionit Gjuhësor	V.Nr.244/2018 V.Nr.245/2018	2
39	Komuna e Istogut	1.Drejtor i Gjinnazit “Hagji Zeka” 2.Zv. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “ Bajram Curri”	V.Nr.196/2018 V.Nr.254/2018	2
40	Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike	1.Udhëheqës i Divizionit për Hulumtime dhe Analiza të Diasporës 2. Drejtor i Divizionit për Buxhet dhe Financa	V.Nr.40/2018 V.Nr.80/2018	2
41	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	1.Drejtor i Divizionit për Evidencë Penale 2. Drejtor i Zyrës për Shërbime të Përgjithshme	V.Nr.302/2018 V.Nr.354/2017	2
42	Ministria e Shëndetësisë	1.Udhëheqës i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit 2. Udhëheqës i Divizionit të Cilësisë dhe Sigurisë të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësorë	V.Nr.269/2017 V.Nr.378/2017	2
43	Komuna e Obiliqit	1. Udhëheqës i Sektorit për Inspektime	V.Nr.134/2018	1
44	Agjencia e Kosovës për Forenzikë	1.Udhëheqës i Divizionit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme	V.Nr.87/2018	1
45	Ministria e Forcës së Sigurisë	1. Drejtor i Drejtorisë për Politikë dhe Plane	V.Nr.15/2018	1
46	Komuna e	1. Drejtor i Teatrit të Qytetit	V.Nr.43/2018	1

	Gjilanit			
47	Komuna e Suharekës	1. Udhëheqës i Sektorit për Turizëm	V.Nr.127/2018	1
48	Komuna e Deçanit	1.Udhëheqës i Sektorit për Mirëqenie Sociale	V.Nr.143/2018	1
49	Organi Shqyrtues i Prokurimit	1. Udhëheqës i Divizionit të Brendshëm	V.Nr.189/2018	1
50	Komuna e Hanit të Elezit	1.Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike	V.Nr.75/2018	1
51	Kuvendi i Kosovës	1. Drejtor i Drejtorisë për Personel	V.Nr.349/2018	1
52	Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës	1.Menaxher i Personelit	V.Nr.62/2017	1
53	Komisioni i Pavarur për Media	1. Udhëheqës i Divizionit për Ankesa dhe Përfaqësim	V.Nr.370/2018	1
54	Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës	1.Udhëheqës i Divizionit për Rregullimin e Arkivave	V.Nr.318/2018	1
55	Qendra e Studentëve të UP-së	1.Udhëheqës i Konviktit	V.Nr.5/2018	1
56	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa	1. Drejtor i Departamentit Ligjor	V.Nr.111/2018	1
57	Agjencia e Menaxhimit Emergjent	3. Udhëheqës i Divizionit për Vlerësimin e Rreziqeve	V.Nr.333/2018	1
58	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	1. Drejtor i Departamentit të Administratës	V.Nr.69/2017	1
59	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	1.Udhëheqës i Divizionit për Planprograme dhe Tekste Shkollore	V.Nr.179/2018	1
Gjithsëjt				225

Tabela nr. 20. Në këtë tabelë pasqyrohen procedurat e mbikëqyrura për pozitat e nivelit drejtues dhe Nivelit të Lartë Drejtues për procedura të rekrutimit që janë aprovuar si të rregullta nga Këshilli.

12. REKOMANDIMET DHE SFIDAT E KËSHILLIT

Këshilli gjatë vitit 2018 është ballafaquar me sfida të ndryshme gjatë ushtrimit të detyrave në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore. Numri i madh i ankesave të parashtruara nga nëpunësit civilë dhe nga kandidatët për pranim në shërbimin civil, ka qenë sfidues për Këshillin, duke marrë parasysh kapacitetet e kufizuara të zyrtarëve për bashkëpunim profesional. Me angazhim maksimal, Këshilli ka arritur që të shqyrtoj dhe zgjidhë 825 ankesa. Edhe përkundër faktit që me Ligjin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës janë zvogëluar afatet e vendimmarrjes në Këshill nga gjashtëdhjetë (60), në katërdhjetë e pesë (45) ditë, në të gjitha rastet, Këshilli ka vendosur brenda afateve të përcaktuara me ligj dhe në asnjë rast nuk ka aplikuar heshtjen administrative.

Po ashtu, në funksionin e mbikëqyrjes së pozitive të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, kemi pasur numër të madh të procedurave, duke arritur numrin maksimal katërqind e katërdhjetë e shtatë (447) procedura. Për të gjitha këto procedura, Këshilli ka nxjerr vendime më të cilin ka aprovuar ose anuluar procedurat, varësisht nga zbatimi apo jo i legjislacionit të shërbimit civil në procedurat përkatëse të përzgjedhjes, të cilat janë prezantuar në këtë raport.

Viti 2018, padyshim shënon një avancim të rolit të Këshillit sepse me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, Këshilli i shtohet edhe funksioni i mbikëqyrës për pozitave të nivelit të lartë drejtues në shërbimin civil, që paralelisht, konsiderohet një sfidë e re për Këshillin, në mënyrë që të mbikëqyrë dhe vendos nëse këto procedura zhvillohen në pajtim me legjislacionin e shërbimit civil dhe aplikohet parimi i meritës në emërimet e larta drejtuese.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për Këshillin, i njëjti është atakuar nga Avokati i Popullit në Gjykatën Kushtetuese me pretendimin se në disa dispozita mund të jetë në kundërshtim me Kushtetutën. Këshilli, sipas kërkesës së Gjykatës Kushtetuese, e ka përgatitur përgjigjen dhe ia ka dërguar Gjykatës Kushtetuese, duke dhënë argumentet e plota se Ligji i Këshillit i aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës është në pajtim të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Siç jeni në dijeni, tanimë Kuvendi i Republikës së Kosovës ka aprovuar pakon ligjore të administratës publike, respektivisht Ligjin për Zyrtarët Publikë në të cilin përfshihet edhe shërbimi civil i Kosovës, Ligjin për Pagat si dhe Ligjin për Organizmin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura. Kjo mund të konsiderohet një arritur e madhe në procesin e reformimit të administratës publike, sidomos në fushën e pagave në sektorin publik sepse për herë të parë po vendoset me një ligj për pagat e gjithë punonjësve të administratës publike, duke vendosur një rregull sipas parimit “pagë e njëjtë për punë të njëjtë”.

Me Ligjin për Zyrtarët Publikë tashmë janë bërë ndryshime të dukshme sa i përket shërbimit civil dhe në këtë ligj janë marrë parasysh disa rekomandime që janë dhënë nga Këshilli në vitet paraprake si dhe gjatë procesit të hartimit të këtij Ligji.

Viti 2019, sigurisht që shënon një kthesë për Këshillin sepse me rastin e ndryshimit të legjislacionit të shërbimit civilë, rrjedhimisht do të ketë ndryshime të praktikës së vendimmarrjes në Këshill në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj duke marr parasysh që do të vendoset praktikë e re e vendimmarrjes, Këshilli duhet të ketë kujdes të shtuar që vendimet e marra sipas legjislacionit të ri të nxjerrën sipas një analize të thellë ligjore dhe kushtetuese, me qëllim që ankesat e trajtuara të jenë në pajtim me legjislacionin dhe të njëjtat vendime të mos shfuqizohen me vonë nga gjykatat.

Me legjislacionin e ri të shërbimit civil, janë shuar Komisionet për Zgjidhjen e Kontesteve dhe te Ankesave të organeve të punësimit, dhe tash të gjitha ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil do të parashtrihen drejtpërdrejtë në Këshill. Kjo do të ndikoj që numri i ankesave në Këshill të rritet.

Këshilli vlerëson se Departamenti për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në krahasim me vitet paraprake, tani i trajton me shpejtë lëndët ne gjykatë që janë ngritur në konflikt administrativ kundër vendimeve të Këshillit, por në raste të caktuara Aktgjykimet e gjykatës të cilat i anulojnë vendimet e Këshillit dhe e kthejnë çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje në Këshill, me arsytim të përgjithësuar, pa dhënë gjetjet dhe konstatimet e sakta, dhe kjo e vështirëson punën e Këshillit si dhe ndikon tek palët tjera në procedurë.

Duke marr parasysh sfidat e konstatuar me lartë si dhe krijimin e rrethanave të reja për shkak të ndryshimit të legjislacionit të Këshillit dhe të shërbimit civil, i rekomandohet institucioneve kompetente, që të ndërmarrin veprimet si në vijim:

- Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht Ministria e Administratës Publike duhet te kujdeset që të nxjerr aktet nënligjore brenda periudhës 6 mujore nga momenti i publikimit në Gazetën Zyrtare të Ligjit për Funksonaret Publikë, në të cilin ligj është përfshirë shërbimi civil i Republikës së Kosovës. Aktet nënligjore duhet të jenë në harmoni me dispozitat ligjore dhe duhet të evitohet kolizioni ligjorë si dhe të evitohen praktikat që me akte nënligjore të rregullohen fusha të caktuara në kundërshtim me dispozitat e ligjit;
- Duhet të definohet aplikimi i përvojës së punës, duke përcaktuar qartë dallimi ndërmjet përvojës së punës dhe përvojës profesionale të punës si dhe mënyra e aplikimit të saj në procedurat e rekrutimit dhe avancimit në shërbimin civil;
- Kuvendi i Republikës së Kosovës që të ketë parasysh rritjen e numrit të bashkëpunëtorëve profesional në Këshill.
- Këshilli duhet të përgatitë një plan për trajnime specifike për stafin mbështetës profesional me qëllim të zbatimit të legjislacionit të ri të shërbimit civil të Republikës së Kosovës; dhe
- Qeveria e Kosovës, respektivisht Ministria e Administratës Publike duhet të siguroj objekt/hapësirë te re të punës për Këshillin e cila duhet të jetë e përshtatshme për

punonjësit e Këshillit dhe duhet të ketë qasje të lehtë për ankuesit.

13. VENDIMET E GJYKATAVE

Gjatë periudhës raportuese, Këshilli ka arritur që të shqyrtoj dhe zgjidhë 825 ankesa. Kundër këtyre vendimeve, palët e pakënaqura kanë parashtruar 156 padi. Nga këto të dhëna rezulton se 669 vendime nuk janë atakuar fare në Gjykatë.

Këshilli gjatë vitit 2018 ka pranuar 270 vendime nga gjykatat e vendit, prej tyre 230 aktgjykime dhe 40 aktvendime.

Këshilli konstaton se me 179 Aktgjykime të gjykatave të vendit janë refuzuar kërkesëpaditë e paditësve kundër vendimeve të Këshillit, duke u vërtetuar vendimet e Këshillit.

Me 40 Aktgjykime të gjykatave të vendit janë aprovuar kërkesëpaditë e paditësve kundër vendimeve të Këshillit duke u anuluar 26 vendime të Këshillit të cilat janë kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje në Këshill.

Me 10 Aktgjykime gjykatat e vendit duke vendosur në mënyrë përfundimtare ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve dhe janë anuluar vendimet e Këshillit.

Me një (1) aktgjykim, Gjykata e Apelit ka refuzuar ankesën e Këshillit të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Prej 43 aktvendimeve që kemi pranuar nga Gjykatat gjatë vitit 2018, gjendja pasqyrohet si në vijim:

- me 13 Aktvendime, Gjykata ka aprovuar kërkesat e palëve për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të Këshillit.
- me 5 Aktvendime, Gjykata ka refuzuar kërkesat e palëve për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të Këshillit.
- me 15 Aktvendime, Gjykata Themelore në Prishtinë ka pezulluar procedurën gjyqësore;
- me 8 Aktvendime janë hedhur poshtë paditë e ushtruara kundër vendimeve të Këshillit;
- me 2 Aktvendime është lejuar tërheqja e padive të ushtruara kundër vendimeve të Këshillit.

Aktgjykimet dhe aktvendimet e Gjykatës janë nxjerr për vendimet e Këshillit gjatë viteve paraprahe, por që janë vendosur nga Gjykata në vitin 2018.

14. BASHKËPUNIMI I KËSHILLIT ME INSTITUCIONET TJERA

Këshilli gjatë vitit 2018, përveç kryerjes së detyrave dhe përgjegjësiwe ligjore, i ka kushtuar rëndësi të madhe edhe ngritjes së bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet vendore, ka pasur bashkëpunim shumë të mirë me Kuvendin e Kosovës, Qeverinë e Republikës së Kosovës, respektivisht Ministrinë e Administratës Publike. Po ashtu, Këshilli i ka ofruar bashkëpunim të plotë Institutit të Kosovës për Administratë Publike, Institutit Gjyqësor të Kosovës, Agjencisë Kundër-Korrupsionit, Prokurorisë së Shtetit dhe Policisë së Kosovës si dhe institucioneve tjera, lidhur me rastet që janë kërkuar për vlerësim në kuadër të funksioneve dhe përgjegjësiwe kushtetuese të Këshillit për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në shërbimin civil.

Gjatë vitit 2018, Këshilli për herë të parë ka nxjerr publikimin e Buletinit të vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Ky Buletin përmban një përmbledhje të vendimeve me të rëndësishme nga funksioni i ankesave, të cilat janë të natyrave të ndryshme të mënyrës së vendimmarrjes, janë të gjitha natyrave të çështjeve juridike si dhe të ankuesve të komuniteteve dhe gjinive të ndryshme.

Gjithashtu, Këshilli, ka pasur një bashkëpunim të hapur me mediat elektronike dhe mediat e shkruara, me shoqërinë civile, duke ju mundësuar prezencë fizike në çdo organizim të Këshillit si dhe duke ju ofruar qasje në çdo dokument apo informacion të kërkuar.

15.KRAHASIMI I PUNËS SË KËSHILLIT PËR VITIN 2018 ME PUNËN E KËSHILLIT PËR VITIN 2017

15.1.Funksioni i shqyrtimit të ankesave

Në tekstin në vijim do të paraqiten të dhënat për punën e Këshillit për vitin 2018 në krahasim me punën e Këshillit për vitin 2017, në pajtim me kërkesën dhe formatin e raportit të punës.

Në vitin 2018 në Këshill janë pranuar gjithsej 863 ankesa kurse në vitin 2017 në Këshill janë pranuar 812 ankesa. Nga kjo e dhënë, konstatohet që në Këshill gjatë vitit 2018 janë pranuar 51 ankesa më shumë se ankesat e pranuar në vitin 2017.

Këshilli, gjatë vitit 2018 ka pasur në shqyrtim 937 ankesa dhe prej tyre ka vendosur për 825 ankesa, në krahasim në vitin 2017 kur ka pasur në shqyrtim 891 ankesa prej të cilave ka vendosur për 817. Nga kjo rezulton që Këshilli gjatë vitit 2018 ka vendosur për 8 ankesa më shumë se sa në vitin 2017.

Këshilli gjatë vitit 2017 ka pasur në shqyrtim 891 ankesa ndërsa në vitin 2018 ka pasur në shqyrtim 937 ankesa. Nga kjo rezulton se Këshilli gjatë vitit 2018 ka pasur në shqyrtim 46 ankesa më shumë se në vitin 2017.

Nga viti 2018 në vitin 2019 janë bartur 38 ankesa më shumë se ankesat e bartura nga viti 2017 në vitin 2018.

Në vitin 2018 organet e punësimit kanë pasur për obligim zbatimin e 286 vendimeve të Këshillit, prej 286 vendimeve, organet e punësimit kanë zbatuar 208 vendime, nuk kanë zbatuar 47 vendime, ndërsa në proces të zbatimit janë edhe 31 vendime.

Nr.	Ankesat/Vendimet	Viti 2018	Viti 2017	Ndryshimi	Krahasimi i ankesave dhe vendimeve në mes të vitit 2018 dhe 2017
1.	Ankesat e pranuar	863	812	51	Këshilli në vitin 2018 ka pranuar 51 ankesa më shumë se në vitin 2017
2.	Ankesat për shqyrtim në Këshill	937	891	46	Këshilli në vitin 2018 ka pasur në shqyrtim 46 ankesa më shumë se në vitin 2017
3.	Ankesat e shqyrtuara në Këshillit (Numri i vendimeve)	825	817	8	Këshilli në vitin 2018 ka nxjerrë 8 vendime më shumë se në vitin 2017
4.	Vendimet e obligueshme për zbatim	286	341	55	Organet e punësimit në vitin 2018 kanë pasur obligim për zbatimin e 55 vendimeve më pak se në vitin 2017
5.	Vendimet e zbatuara	253	232	21	Numri i vendimeve të zbatuara është 21 më shumë se në vitin 2017

6.	Vendimet e pazbatuara	15	46	31	Në vitin 2018 kanë qenë 31 vendime të pazbatuara më pak se sa në vitin 2017 vendime.
7.	Ankesat e bartura në vitin vijues	112	74	38	Nga viti 2018 në vitin 2019 janë bartur 38 ankesa më shumë se nga viti 2017 në vitin 2018

Tabela nr.21 paraqet krahasimin e ankesave të pranuar, ankesave në shqyrtim si dhe vendimet e nxjerra gjatë vitit 2018 dhe 2017.

15.2. Funkzioni i mbikëqyrjes të procedurës së rekrutimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues dhe nivelit të lartë drejtues

Këshilli gjatë vitit 2018 ka mbikëqyrur 447 procedura për procesin e emërimeve të nëpunësve civil të nivelit drejtues dhe të nivelit të lartë drejtues. Nga 447 procedura që janë mbikëqyrur, Këshilli ka aprovuar 225 procedura të rekrutimit, ndërsa ka anuluar 222 procedura të rekrutimit për shkak të shkeljeve ligjore dhe procedurale.

Në bazë të këtyre të dhënave, konstatohet që Këshilli në vitin 2018 ka mbikëqyrur 135 procedura të rekrutimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues dhe të nivelit të lartë drejtues më shumë se në vitin 2017.

Nr.	Procedura e mbikëqyrjes	Viti 2018	Viti 2017	Ndryshimi	Krahasimi i procedurës së mbikëqyrjes
1	Procedurat e mbikëqyrjes lidhur me procesin e emërimeve të nëpunësve civil të nivelit drejtues dhe të nivelit të lartë drejtues	447	312	135	Këshilli në vitin 2018 ka mbikëqyrur 135 pozita të rekrutimit më shumë se në vitin 2017
2	Procedurat e aprovuara	225	164	61	Këshilli në vitin 2018 ka aprovuar 61 pozita të rekrutimit më shumë se në vitin 2017
3	Procedurat e anuluar	222	148	74	Këshilli në vitin 2018 ka anuluar 74 pozita të rekrutimit më shumë se në vitin 2017.

Tabela nr.22 paraqet krahasimin e procedurës së mbikëqyrjes për vitin 2018 dhe 2017

15.3.Funksioni i monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil

Këshilli për vitin 2018, ka realizuar 63 vizita monitoruese dhe ka përgatitur pesëdhjetë e nëntë 59 raporte të monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Këshilli në vitin 2017 ka realizuar 81 vizita monitoruese. Kjo nënkupton që Këshilli në vitin 2018 ka realizuar 18 vizita monitoruese më pak se në vitin 2017.

Në raportet e vitit 2018 të monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për 63 institucione të nivelit qendror dhe lokal, Këshilli, ka evidentuar dhe ka konstatuar 352 shkelje të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, dhe për shkeljet e evidentuara ka dhënë 383 rekomandime për zyrtarët përgjegjës të institucioneve të monitoruara.

Nr.	Funksioni i monitorimit	Viti 2018	Viti 2017	Ndryshimi	Krahasimi i procedurës së monitorimit për vitin 2018 dhe 2017
1	Vizitat monitoruese të realizuara	63	81	18	Këshilli në vitin 2018 ka monitoruar 18 institucione më pak se në vitin 2017.

Tabela nr.23 paraqet krahasimin e procedurës së monitorimit për vitin 2018 dhe 2017

16. RAPORTI PËR SHPENZIMIN E BUXHETIT TË KËSHILLIT

Buxheti fillestar i aprovuar për Këshillin, sipas Ligjit 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, ka qenë në shumën prej :380.663.00 Euro.

Sipas ligjit buxheti i Këshillit është ndarë në këto kategori ekonomike:

Në kategorinë ekonomike Paga dhe Mëditje: Buxheti i aprovuar ,është në shumë: **259.480.00€**

Në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime: Buxheti i aprovuar është në shumë: **117.358.00€**

Në kategorinë ekonomike Shpenzime komunale: Buxheti i aprovuar është në shumë:**3.825.00€**

Nr	Kategoritë Ekonomike	Buxheti fillestar aprovuar sipas Ligjit 06/L-020 A	Buxheti i rishikuar B	Ndryshimi C=A-B	Buxheti Final-SIMFK D=B
1	Paga dhe mëditje	259.480.00	258.344.72	(1.135.28)	258.344.72
2	Mallra dhe shërbime	117.358.00	117.358.00	00	117.358.00
3	Shpenzime komunale	3.825.00	3.825.00	00	3.825.00
4	Shpenzime kapitale	00	00	00	00
	Totali	380.663.00	379.527.72	1.135.28	379.527.72

Tabela nr. 24 paraqet Ndarjen dhe alokimin e mjeteve sipas kategorive ekonomike

Nga tabela e nr.24, shihet qartë se ka dallim (ndryshim) në mes të buxhetit të fillestar dhe buxhetit final si SIMFK.

Nga pasqyra e cekur më lartë, shohim se ka ndryshim në mes buxhetit fillestar(ndarja),dhe buxhetit final (SIMFK),në shumë prej:1.135.28euro,sepse Qeveria me vendim nr.02/70,date 19.10.2018,Keshillit ia ka marr shumën prej:(8,809).euro nga kategoria Paga dhe shtesa, kurse me vendim nr.07/80,18.12.2018, Qeveria i ka ndarë Këshillit në kategorinë: Paga dhe shtesa shumën prej: 7.674.euro.

Gjatë vitit 2018, nga buxheti i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Këshilli ka shpenzuar në total: **98.06%** të buxhetit. Buxheti i shpenzuar në kategoritë ekonomike është si vijon:

Në kategorinë ekonomike Paga dhe Mëditje: Buxheti është shpenzuar në masën prej **98.90%**.

Në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime: Buxheti është shpenzuar në masën **97.14%**.

Në kategorinë ekonomike Shpenzime komunale: Buxheti është shpenzuar në masën **69%**.

Nr.	Kodi buxhetor 249	Buxheti final 2018	Buxheti i shpenzuar	Buxheti i pa- shpenzuar	Të shprehura në%
1	Paga dhe mëditje	258.344.72	255.515.22	2.829.50	98.90%
2	Mallra dhe shërbime	117.358.00	113.998.87	3.359.13	97.14%
3	Shpenzime komunale	3.825.00	2.639.08	1.185.92	69 %
4	Shpenzime kapitale	00	00	00	00
	Totali	379.527.72	372.153.17	7.374.55	98.06%

Tabela nr. 25 paraqet shpenzimet e buxhetit sipas kategorive ekonomike